

VENDIM
Nr.736, datë 1.7.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.808, DATË 4.12.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT PËRDORUESVE TË
MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.808, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “leje manovrimi” zëvendësohen me “dëshmi aftësie”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. a) Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shfrytëzimit të Transportit Rrugor të ngrihet komisioni i posaçëm për dhënien e dëshmisë së aftësisë, për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit.

b) Kushtet dhe kriteret për dhënien e dëshmisë së aftësisë përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit përcaktohen në rregulloren, që do të hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe do të miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.”.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Kurset teorike e praktike, për përgatitjen e manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike private, që plotësojnë kushtet e parashikuara në rregulloren e përmendur në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij vendimi.”.

d) Pikat 2 e 5 shfuqizohen.

e) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha